REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT
Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVES
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA / POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
Hajvali - Prishtine
Nr. 04-052-652/2
Data / Datum 16.07.2025

Referencë: **IPK/08072025/DI**
Datë: **08.07.2025**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (ZKM) Nr. 03/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për Procedurën e Planifikimit, Inspektimit dhe Raportimit, Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së, dhe Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta (2025), Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Përdorimi i teknologjisë për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve
Referenca	- 04/2025
Data e inicimit	- 02.04.2025
Data e raportimit	- 08.07.2025
Arsyet e inicimit	- Më 24.03.2025, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së z. Kushtrim Hodaj ka kërkuar nga Departamenti i Inspektimit, që të realizojë inspektim të jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar praktikat e përdorimit të pajisjeve për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve në rrugë. Në bazë të informatave të siguruara, është pretenduar se zyrtarët policor të trafikut gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në rrugët rajonale dhe autostrada, përkundër faktit së përdorin radarët laserik në rastet e mos respektimit të kufizimit të shpejtësisë së lejuar të lëvizjes, të njëjtit për arsye ndryshme nuk i gjobisin kundërvajtësit për shkeljet e kryera. Është e ditur se Policia e Kosovës ka në përdorim teknologji të avancuar për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve, me karakteristika që mundëson ruajtjen e evidencave në memorien e pajisjeve për një afat të caktuar. Ky inspektim ad hoc ka ofruar mundësi për t'u njohur me përdorimin efektiv të pajisjeve dhe për të verifikuar nëse njësitë policore përgjegjëse u ekspozohen abuzimeve eventuale.
Objektivat e inspektimit	- Identifikimi i teknologjisë për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve, - Vlerësimi i përdorimit racional e efektiv i pajisjeve, në rastet e rrezikimit të trafikut nga ngasës që nuk respektojnë kufizimet për shpejtësinë e lejuar, - Vlerësimi i përputhjes së numrit të matjeve me të kundërvajtjeve - gjobave.
Metodologjia e inspektimit	Gjatë realizimit të punës inspektuese është aplikuar metodologjia si në vijim: (a) Janë realizuar takime me drejtues dhe bartës të funksioneve, si: - Udhëheqësin e Divizionit të Trafikut Rrugor, - Shefat e Njësive Rajonale të Trafikut Rrugor; - Zyrtarë përgjegjës të Divizionit të Trafikut Rrugor, të angazhuar për menaxhimin e radarëve, përfshirë dhe veturat me pajisje inteligjente; (b) Kontrolle (këqyrje - verifikime) të: - prezencës së radarëve dhe pajisjeve inteligjente në automjete, - funksionimit në terren të pajisjeve për matjen e shpejtësisë, - prezencës së materialeve të regjistrimeve të matjeve me pajisje; (c) Marrja e dokumenteve fizike dhe elektronike, si: - Materiali i regjistruar nga 13 radar laserik dore, 3 pajisje inteligjente në automjete dhe 1 radar mobil, dhe - fletë kundërvajtjet për mostrat e matjeve të regjistruara.

Subjekti	- Divizioni i Trafikut Rrugor dhe Njësitë Rajonale të Trafikut Rrugor.
Afatet e inspektimit	- Fillimi - 07.04.2025; - Përfundimi - 08.04.2025; - Periudha e mbulimit: Janar - Maj 2025 dhe gjendja aktuale.
Kriteri vlerësues (standardi)	- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, - Ligji Nr. 08/L-076 për Rregullat e Trafikut Rrugor, - Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2012 për Mënyrën e Kryerjes së Detyrave dhe Autorizimeve Policore, dhe - Rregullore për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, - Procedura Standarde e Operimit - Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor - Procedura Standarde e Operimit - Njësia për Kontroll të Autostradave.
Takimi përmbyllës (IPK-Policia e Kosovës)	- Më 04.07.2025 është realizuar takimi përmbyllës me strukturat policore të inspektuara, të përfaqësuar nga drejtues/bartës funksionesh nga Departamenti i Rendit Publik, Divizioni i Trafikut Rrugor, përfshirë edhe Njësinë Rajonale të Trafikut Rrugor - Prishtinë dhe Njësinë për Kontrollin e Autostradës.
Komentet policore lidhur me gjetjet dhe rekomandime	- Më 07.07.2025, struktura e inspektuar policore ka kthyer komentet lidhur me rekomandimet dhe Planin e veprimit të realizimit të tyre, të cilat janë bërë pjesë e këtij Raporti të inspektimit.

Ekipi realizues	- Xhavit Fetahaj, inspektor
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Drejtuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv Inspektorati Policor i Kosovës
Datë	- 08.07.2025

Shkurtesat

DTRR	**Divizioni i Trafikut Rrugor**
IPK	**Inspektorati Policor i Kosovës**
PSO	**Procedura Standarde e Operimit**
NJMTRR	**Njësia për Mbështetje të Trafikut Rrugor**
NJPMRR	**Njësia për Përcjelljen e Materieve të Rrezikshme**
NJMPI	**Njësia Mobile me Pajisje Inteligjente**
NJKA	**Njësia për Kontroll të Autostradës**
NJRTRR	**Njësia Rajonale e Trafikut Rrugor**
UA	**Udhëzimi Administrativ**

Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet

Inspektimi nxjerrë në pah se:

- *Inspektimi vë në pah dobësi në vendosjen e të dhënave në radar para matjeve nga zyrtarët policor të ekipeve patrulluese, si dhe praktika të ndryshme të shkarkimit dhe ruajtjes së regjistrimeve të matjeve, të cilat mund të eliminohen me trajnime shtesë apo procedura të shkruara të operimit.*
- *Lidhur me performancën e njësive të trafikut në ngritjen e sigurisë rrugore janë hasur dobësi në pasqyrimin e të dhënave në gjoba në raport me shkeljet, që sjellin dyshime se mund të abuzohet gjatë kryerjes së detyrës, të cilat mund të eliminohen me kontrolle të shtuara menaxheriale.*
- *Me gjithë punën që bëhet, pasqyrohet në pamje të përgjithshme sikur nuk shfrytëzohen efektivisht mundësitë që ofrojnë pajisjet e avancuara, me të cilat janë pajisur njësitë policore, duke bërë që shumë kundërvajtje të mos trajtohen dhe të mos marrin goditjen e duhur përmes forcës së ligjit.*

Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. *IPK i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Trafikut Rrugor, që të ndërmarrë veprime në drejtim të nxjerrjes së një udhëzuesi lidhur me përdorimin e pajisjeve për matjen e shpejtësisë së lëvizjes, përfshirë dhe ruajtjen e regjistrimeve, në të kundërtën, mbajtja e një trajnimi shtesë do të ishte i duhur për të pajisur personelin me njohuri të mjaftueshme.*
2. *IPK iu rekomandon shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve në kuadër të njësive rajonale të trafikut rrugor, që të ushtrojnë kontrolle mbi ekipet patrulluese, në drejtim të eliminimit të dobësive sa i përket vendosjes së të dhënave në pajisjet e matjes së shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve (kufizimi i shpejtësisë, lokacioni, operatorët).*
3. *IPK iu rekomandon shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve në kuadër të njësive rajonale të trafikut rrugor, që të ushtrojnë kontrolle mbi ekipet patrulluese, në drejtim të eliminimit të praktikave të dëmshme (ndryshimi i llojit të shkeljes, mos aplikimi i plotë i gjobës, të dhëna kontradiktore ndërmjet shpejtësisë së matur me atë të përshkruar në gjobë, etj.), duke konsideruar se ulin seriozitetin dhe profesionalizimin.*
4. *IPK iu rekomandon shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve në kuadër të njësive rajonale të trafikut rrugor, që sigurohen se ekipet patrulluese janë duke shfrytëzuar mjaftueshëm automjetet me pajisje inteligjente, në identifikimin e kundërvajtësve që rrezikojnë komunikacionin duke lëvizur me shpejtësi mbi atë të lejuar, por edhe identifikimin edhe të atyre që qarkullojnë me automjete të pa regjistruara.*
5. *IPK iu rekomandon shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve në kuadër të njësive rajonale të trafikut rrugor, që të monitorojnë procesin e shkarkimit të materialeve të regjistruara nga pajisjet e matjes së shpejtësisë, duke siguruar se ato edhe ruhen në mënyrën e duhur.*
6. *IPK i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Trafikut Rrugor dhe shefave të njësive rajonale të trafikut rrugor, që të ndërmarrë veprime në drejtim të aplikimit të praktikës së printimit të kundërvajtjeve, në rastet e matjeve me radar të dorës Trucam nga njësitë patrulluese.*
7. *IPK i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Trafikut Rrugor, që në bashkëpunim edhe me Ministrinë e linjës, të shqyrtojë mundësitë e pajisjes edhe me radar statik, për të ushtruar kontroll efektiv mbi kundërvajtësit në zona me rrezik të lartë, të njohura si pika të nxehta të ndodhjes së aksidenteve rrugore.*

Gjetjet	**1. Menaxhimi i pajisjeve për matjen e shpejtësisë së lëvizjes** 1.1. Është e njohur se Policia e Kosovës zhvillon aktivitet në ngritjen e sigurisë rrugore dhe qarkullimin normal të trafikut rrugor. Për menaxhimin e sigurisë rrugore në kuadër të Strukturës Organizative të Policisë funksionon Divizioni i Trafikut Rrugor (DTRR), brenda të cilit ka drejtori dhe njësi operative të veçanta, të cilat ndërmarrin aktivitete që synojnë ngritjen e sigurisë rrugore. Drejtoria e Autostradave në kuadër të Divizionit operon me Njësinë e Kontrollit të Autostradës "Ibrahim Rugova dhe Arbën Xhaferi" dhe Njësinë e Kontrollit të Autostradave Prishtinë - Gjilan e Prishtinë - Merdare. NJKA është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor në të gjitha autostradat e Republikës së Kosovës, si dhe në magjistralen Fushë Kosovë në drejtim të Pejës deri në Gjurgjicë dhe anasjelltas[1]. Në kuadër të Divizionit operon edhe Njësia e Përcjelljes së Materieve të Rrezikshme, Njësia e Mbështetjes së Trafikut Rrugor dhe Njësia Mobile me Pajisje Inteligjente, njësi këto të cilat kanë për detyrë kontrollin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të veçanta të sigurisë së trafikut rrugor. Në drejtori rajonale policore funksionojnë Njësitë Rajonale të Trafikut Rrugor (NJRTRR), përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor në të gjitha rrugët magjistrale, rajonale dhe brenda Kryeqytetit të Republikës së Kosovës[2]. Këto njësi veprojnë direkt në kuadër të drejtorive rajonale dhe në mënyrë indirekte ndërlidhen me DTRR. 1.2. Numri më i madh i aksidenteve ndodhin për shkak të mospërshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes nga pjesëmarrësit në trafik, si pasojë e të cilave shkaktohen humbje të jetëve të njerëzve, lëndime trupore e dëme materiale. Policia ka një rol aktiv në parandalimin e ngjarjeve të tilla dhe sa më aktive që të jetë, numri i aksidenteve mund të reduktohet, me çka krijohen parakushte edhe për siguri më të madhe rrugore. Për të mbikëqyrur e kontrolluar respektimin e kufizimit të shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve në rrugë, Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor në nenin 242 ka paraparë që *"përcaktimi i shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve konstatohet me pajisje të matjes së shpejtësisë së lëvizjes së mjetit, me të dhëna në tahograf, duke përcjellë drejtpërdrejt mjetin me anë të video-incizimeve, me pajisje mobile e statike, apo të ngjashme"*. Në nenin 19 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2012 për Mënyrën e Kryerjes së Detyrave e Autorizimeve Policore potencohet se *"Policia autorizimet e saj i zbaton me mjete e veprime, me të cilat arrihet përmbushja e detyrave të përgjithshme të Policisë, me pasoja sa më pak të dëmshme dhe për kohë sa më të shkurtër të mundshme"*. Edhe Rregullorja për Personel e Administratë në Policinë e Kosovës në nenin 193 përcakton se *"zyrtarët policor gjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore, veç pajisjeve policore të përcaktuar me Udhëzim Administrativ për përdorimin e forcës, përdorin edhe pajisje e mjete tjera shtesë*, ndër to, dhe matësin e shpejtësisë së lëvizjes (radarin). Normativa e potencuar më lartë pasqyron se lejohet që njësitë policore të trafikut, të përdorin pajisje për matjen e shpejtësisë së lëvizjes. 1.3. Njësitë e trafikut kanë në përdorim pajisje me teknologji mirë të avancuar për matje të shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve, me specifika teknike që mundësojnë dokumentim dhe ruajtje të evidencave për një afat të caktuar. Këto arritje teknologjike mundësojnë që regjistrimet nga matjet e shpejtësisë përmes pajisjeve, të lexohen dhe të barten jashtë memories së tyre, për të mundësuar përveç tjerash dhe mbikëqyrjen e punës së njësive policore. Sa i përket pajisjes së njësive policore, IPK ka pasur fokus në këto pajisje të avancuara, që janë blerë viteve të fundit. Andaj, nga radhët e këtyre pajisjeve për matje të shpejtësisë së lëvizjes, njësitë policore tanimë kanë në përdorim radar laserik Trucam II, radar mobil të vendosur në automjete policore dhe automjete me pajisje inteligjente. Radarët Trucam II janë radarë dore, ata mobil funksionojnë nga automjetet, zakonisht civile, radarët e tretë funksionojnë nga automjetet, që në rrugë shfaqen transparente.

[1] Departamenti për Operacione, *Procedura Standarde e Operimit - Menaxhimi, kontrollimi dhe mbikëqyrja e Autostradave të Republikës së Kosovës,* nr. ref.: DDO - 04/076/2016 (datë 8 gusht 2016).

[2] Departamenti për Operacione, *Procedura Standarde e Operimit - Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor,* nr. ref.: 04/3/387/2014 (datë 14 nëntor 2014).

	1.4. Radarët e dorës të llojit Trucam që janë në përdorim nga viti 2018, ofrojnë mundësi të vendosjes në to, të shënimeve për njësinë, operatorët, lokacionet e matjes, kufizimin e shpejtësisë së lejuar në zonën ku patrullohet, etj. Incizimi dhe ruajtja e të dhënave të matjeve nga radarët bëhet automatikisht në memory card, me çka mundësohet printimi i imazheve me printer mobil. Të dhënat e matjeve me radar mund të lexohen, shikohen, shkarkohen e të ruhen në hapësira tjera memorizuese jashtë pajisjes së radarit. Ky radar posedon GPS dhe bën matje laserike të shpejtësisë së lëvizjes, por nuk i lexon dhe ruan automatikisht të dhënat mbi mjetin. Identifikimi i shënimeve të mjeteve mund të bëhet në bazë të imazheve, cilësia e të cilave varet nga kushtet natë-ditë dhe distanca e matjes. Policia e Kosovës ka 59 radarë Trucam II, të shpërndarë në: DTRR (4 sosh), NJKA (10) dhe në njësitë rajonale të trafikut (45). Për shkak të defekteve, jo të gjithë radarët kanë qenë duke funksionuar gjatë periudhës sa është zhvilluar inspektimi. 1.5. Njësitë policore të trafikut kanë në përdorim një kontingjent të radarëve mobil nga Maji i vitit 2024, kurse me pjesën tjetër janë pajisur në fillim këtij viti. Gjatë përdorimit, këto pajisje ofrojnë mundësi të regjistrimit gjatë tërë kohës kur automjeti është i ndezur, duke ofruar mundësi të krijimit edhe të imazheve me fotografi të mjeteve gjatë matjes së shpejtësisë së lëvizjes. Të dhënat e regjistruara në mënyrë automatike ruhen në Hard diskun PC të pajisjes së instaluar. Video materialet ruhen automatikisht për shtatë (7) ditë kalendarike, kurse ato me foto ruhen për një periudhë me të gjatë disa mujore. Të dhënat që përpunohen nga pajisja ruhen dhe regjistrohen automatikisht dhe kur fillon të zvogëlohet hapësira memorizuese, fillojnë të shlyhen ato të mëhershmet. Të dhënat e memoruara nga këta radarë mund të printohen si foto, kurse ato me video mund të shkarkohen dhe ruhen në hapësira tjera memorizuese jashtë pajisjes. Mangësi e këtyre pajisjeve është se matjet duhet shënjestruar saktë, për të hequr dilemat nëse radari ka mundur të matë shpejtësinë e ndonjë mjeti tjetër. Policia e Kosovës ka 13 radarë mobil që funksionojnë nga automjetet e patrullave, të shpërndara në: DTRR (2 sosh), NJKA (2) dhe nga një (1) për çdo njësi rajonale të trafikut rrugor. 1.6. Po ashtu, njësitë policore të trafikut i kanë në përdorim edhe automjetet me pajisje inteligjente, një kontingjent i të cilave është i disponueshëm nga Korriku i vitit 2022, një tjetër nga muaji Qershor i vitit 2023 dhe i fundit nga Nëntori i vitit të kaluar. Kjo pajisje ofron mundësi të regjistrimit gjatë tërë kohës kur automjeti është i ndezur dhe identifikon disa lloje të kundërvajtjeve, por Policia e Kosovës kryesisht ka të zhvilluar programin për matjen e shpejtësisë dhe identifikimin e mjeteve, të cilat qarkullojnë të pa regjistruara. Te këto pajisje të dhënat regjistrohen automatikisht në hard disk (tablet) të pajisjes dhe kapaciteti i saj varet nga vëllimi i punës së operimit, ku regjistrimet e mëhershme zëvendësohen me ato të reja. Kundërvajtjet që kapen nga regjistrimet mund të printohen si dëshmi për palët. Këto pajisje funksionojnë përmes internetit, duke lidhë pjesën e pajisjes operative me tablet, por ndodhë që për shkak të mungesës të rrjetit, pajisja të mos funksionojë. Policia e Kosovës posedon 13 automjete të tilla me pajisje inteligjente, të shpërndara në: DTRR (3) dhe në njësitë rajonale të trafikut rrugor). 1.7. Përdorimi i pajisjeve të reja me teknologji të avancuar paraqet një sfidë edhe në përdorimin efikas të tyre nga personeli. IPK është interesuar të njihet nëse Policia e Kosovës ka ndonjë procedurë të shkruar, që do të shërbente si udhërrëfyes për mënyrën e përdorimit të pajisjeve dhe administrimit të të dhënave. Përveç Manualit të përdorimit të siguruar nga prodhuesi i radarëve të dorës Trucam, Policia nuk ka ndonjë dokument, që rregullon këto çështje. IPK është njohur nga përdoruesit e radarëve, se ka ngecje në këtë drejtim, ku edhe inspektimi vë në pah dobësi evidente. Njësitë e trafikut rrugor nuk kanë një qartësi për ruajtjen e të dhënave dhe inspektimi ka vë në pah praktika të ndryshme të trajtimit të kësaj çështjeje. NJRTRR - Gjakovë përmes programit të ofruar nga kontraktori, të dhënat i ruan në file të veçantë. NJKA bën pjesshëm ruajtjen e të dhënave, derisa njësitë tjera i shkarkojnë pa i ruajtur, apo nuk i shkarkojnë fare. Ndërsa, të dhënat e regjistruara nga radarët tjerë ruhen brenda pajisjeve, varësisht nga vëllimi i regjistrimeve.

1.8. Përdorimi i pajisjeve kërkon përgatitje të personelit me njohuri të nevojshme rreth mundësive që ofrojnë ato në praktikë. Bazuar në informatat e siguruara nga personeli përgjegjës për menaxhimin e pajisjeve për matjen e shpejtësisë sipas llojeve të tyre, pas shpërndarjes së tyre nëpër njësi, DTRR me kontraktorin ka mbajtur sesione trajnimi nëpër këto njësi për realizimin e programit trajnues për përdorimin e pajisjeve. Sipas Zyrtarit menaxhues për radarë laserik Trucam II, në secilën njësi të pajisur me radarë janë organizuar dhe mbajtur trajnime për stafin, për t'i ofruar njohuri mbi përdorimin praktik të tyre. Krahas programit trajnues, në secilën njësi është ofruar edhe udhëzuesi. Sipas Zyrtarit menaxhues për radarët mobil, në fund të vitit 2024 dhe në fillim vitin 2025, në secilën njësi rajonale janë organizuar dhe mbajtur trajnime për stafin, për t'i ofruar njohuri mbi përdorimin praktik dhe efikas të radarëve. Po ashtu, edhe për pajisjet inteligjente në automjete, Zyrtari përgjegjës ka njoftuar se në secilën njësi rajonale të trafikut janë organizuar trajnime për të ofruar njohuri mbi përdorimin e pajisjeve.

1.9. Gjatë përdorimit të radarit laserik Trucam, përdoruesi ka mundësi për të vendosur në të, kufizimin e shpejtësisë së lejuar të lëvizjes së mjeteve në zonën e caktuar (speed limit) dhe shënime tjera për: lokacionin e matjes, njësinë policore dhe operatorët. Pas matjes së bërë, pajisja mes tjerash regjistron kohën e matjes dhe shpejtësinë e lëvizjes së mjetit. Nga kontrollimi i 17 radarëve janë nxjerrë për verifikim 590 mostra të matjeve për mjetet që kanë lëvizur me mbi 20 km/h mbi shpejtësinë e lejuar. IPK është interesuar të njihet nëse njësitë gjatë përdorimit, shfrytëzojnë si duhet mundësitë teknologjike që ofrojnë pajisjet. Kontrolli i mostrave të matjeve në të gjitha njësitë pasqyron se:

- në **25%** të tyre, operatorët nuk kanë vendosur në radar, kufizimin e shpejtësisë (speed limitin) në zonat ku kanë operuar (Mitrovicë Jug, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe NJKA në masën 100%, Prishtinë dhe Ferizaj në masën 87%, përkatësisht 50%, kurse Gjilan dhe DTR në asnjë rast të vetëm).
- në **74%** të tyre, nuk kanë vendosur shënime për lokacionet ku janë kryer matjet (Mitrovicë Jug në masën 100%, NJKA dhe Prizren në masën 77%, përkatësisht 50%, kurse njësitë tjera në asnjë rast të vetëm).
- në **77%** të tyre nuk kanë vendosur shënimet e operatorëve (derisa Mitrovicë Jug e ka bërë në pjesën më të madhe të mostrave, NJKA dhe Prizreni e kanë bërë në gjysmën e mostrave, njësitë tjera në asnjë rast të vetëm).

Tabela 1 - Të dhënat që mungojnë në pajisjet e matjes së shpejtësisë (Trucam II)

Njësia	Mostra	Kufizimi i shpejtësisë	%	Lokacioni i matjeve	%	Operatori	%
Ferizaj	69	60	87	0	0	0	0
Gjilan	35	0	0	0	0	0	0
Prishtinë	70	35	50	0	0	0	0
Mitrovicë J	70	70	100	70	100	67	96
Prizren	70	70	100	35	50	35	50
Pejë	70	70	100	0	0	0	0
Gjakovë	70	70	100	0	0	0	0
NJKA	66	66	100	51	77	34	52
DKR	70	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	590	441	75%	156	26%	136	23%

1.10. Në fokus të këtij inspektimi ka qenë dhe shkalla e ndështkimit në raport me shkeljet nga matjet e regjistruara lidhur me tejkalimin e shpejtësisë së lejuar të lëvizjes. Nga 590 mostra të matjeve me radar Trucam, për tejkalim të shpejtësisë së lejuar të lëvizjes (me mbi 20 km/h), njësitë e trafikut në 208 raste kanë shqiptuar gjoba për ngasësit, të cilët kanë shkaktuar kundërvajtje. Këta indikatorë pasqyrojnë se gjobat janë aplikuar në 35% të shkeljeve të konstatuara me radarë (1 gjobë në 2.8 shkelje të regjistruara). Inspektimi i mostrave ka pasqyruar se ato që lidhen me njësitë e trafikut në Prizren dhe Gjakovë kanë rezultuar me numër më të madh të gjobave, duke i bërë këto njësi të paraqiten më strikte në kryerje të detyrës. Mostrat e inspektuara të NJRTRR - Prishtinë pasqyrojnë se kjo njësi është më tolerante përkundër shkeljeve që i regjistrojnë pajisjet e tyre të matjes.

Tabela 2 - Shkalla e ndëshkimit me gjobë nga përdorimi i radarëve (Trucam II)					
Njësia e trafikut	Numri i radarëve	Numri i mostrave	Numri i gjobave	%	Raporti gjobë kundërvajtje
Ferizaj	2	69	20	29	1 : 3.5
Gjilan	1	35	9	26	1 : 3.9
Prishtinë	2	70	10	14	1 : 7.0
Mitrovicë Jugu	2	70	31	44	1 : 2.3
Prizren	2	70	38	54	1 : 1.8
Pejë	2	70	26	37	1 : 2.7
Gjakovë	2	70	37	53	1 : 1.9
NJKA	2	66	19	29	1 : 3.5
DKR	2	70	18	26	1 : 3.9
Gjithsej	17	590	208	35%	1 : 2.8

1.11. Në 84 nga 208 mostra/gjoba (40%) ka mospërputhje ndërmjet të dhënave në gjoba, me të rezultateve të matjeve. Mospërputhjet janë identifikuar në secilën prej njësive, në përjashtim të NJRTRR - Prishtinë, ku nuk është hasur asnjë rast i vetëm. Në 75 prej 84 mostrave që kanë mos përputhje të të dhënave, dyshohet se është synuar zbutja e dënimit dhe shmangia nga një gjobë më e rëndë, derisa në 9 prej 84 mostrave, nuk dihet arsyeja se pse janë lëshuar këto mospërputhje. Gjatë krahasimit të të dhënave në gjoba dhe atyre të regjistruara në radar, janë hasur katër (4) natyra të mos përputhjeve, si:

- shpejtësia e lëvizjes së mjetit e përshkruar në gjobë, është më e ulët se ajo e regjistruar në radar (në 55 nga 84 mostra/gjoba),
- shpejtësia e kufizuar në radar ndryshon nga ajo e regjistruar në gjobë (në 23 nga 84 mostra/gjoba),
- lloji i shkeljes në gjobë ndryshon nga ajo e matur me radar (në 3 nga 84 mostra),
- shqiptohet gjobë për tejkalim të shpejtësisë së lëvizjes në bazë të një paragrafi (neni) jo adekuat të ligjit (në 3 nga 84 mostra/gjoba).

Tabela 3 - Mospërputhjet në të dhëna (kundërvajtje - gjobë) dhe natyra e tyre						
Njësia	Numri i rasteve	%	Natyra e mospërputhjeve			
			Reduktim shpejtësie në gjobë	Ndryshim i speed limit (radar/gjobë	Ndryshimi i llojit të shkeljes	Mosaplikim i nenit adekuat të ligjit
Ferizaj	15 (20)	75	9	5	1	0
Gjilan	2 (9)	22	1	0	1	0
Prishtinë	0 (10)	0	0	0	0	0
Mitrovicë J	12 (31)	39	11	1	0	0
Prizren	18 (38)	47	15	2	1	0
Pejë	13 (26)	50	2	11	0	0
Gjakovë	12 (37)	32	7	3	0	2
NJKA	7 (19)	37	7	0	0	0
DKR	5 (18)	28	3	1	0	1
Gjithsej	84 (208)	40	55	23	3	3

1.12. Kontrolli i 34 mostrave të matjeve me shkelje të memorizuar nga radari mobil i NJKA, pasqyron se në të gjitha rastet, patrulla policore që ka operuar me këtë pajisje ka aplikuar vendosjen me kohë në radar, të kufizimit të shpejtësisë së lëvizjes sipas zonës ku ka operuar. Në 26 nga 34 mostra (76%) është gjetur se njësitë policore kanë shqiptuar gjoba për ngasësit, të cilët kanë tejkaluar kufizimin e shpejtësisë së lëvizjes. Në 16 nga 26 mostra/gjoba (62%) ka mospërputhje ndërmjet të dhënave në gjoba, me të rezultateve të matjeve me radar. Në 14 prej 16 mostrave që kanë mospërputhje të dhënash, dyshohet se është synuar zbutja e dënimit dhe shmangia nga gjoba më e rëndë, derisa në 2 prej 16 mostrave, nuk dihet arsyeja se pse janë mospërputhjet. Gjatë krahasimit të të dhënave në gjoba dhe atyre të regjistruar në radar, janë evidentuar katër (4) natyra të mos përputhjeve, si:

	- shpejtësia e lëvizjes së mjetit e përshkruar në gjobë, është më e ulët se ajo e regjistruar në radar (në 8 nga 16 mostra/gjoba), - shpejtësia e kufizuar në radar ndryshon nga ajo e regjistruar në gjobë (në 4 nga 16 mostra/gjoba), - për shkeljen e evidentuar me radar, ka pasuar sanksion i pjesshëm (3 nga 16 mostra/gjoba), - shqiptohet gjobë për tejkalim të shpejtësisë së lëvizjes në bazë të një paragrafi (neni) jo adekuat të ligjit (në 1 nga 16 mostra/gjoba). 1.13. IPK ka inspektuar funksionimin edhe të tre (3) automjeteve me pajisje inteligjente: DTRR (NJMPI), NJRTRR- Prizren dhe NJRTRR- Gjakovë. Personeli i NJMPI tashmë ka filluar me aplikimin e dërgimit të gjobave përmes postës. Dërgesës së gjobës përmes postës, i bashkëngjitet edhe formulari me të dhënat e kundërvajtjes, së bashku edhe me fotografi, shkrepur nga pajisja inteligjente. Nga 35 mostra regjistrimesh të inspektuara që ka bërë automjeti, janë dokumentuar 35 gjoba të shqiptuara për tejkalim të shpejtësisë dhe ngasje të mjetit të pa regjistruar. Në një rast, gjoba për tejkalim të shpejtësisë nuk është shqiptuar e plotë, ku krahas gjobës në të holla nuk është shqiptuar masa mbrojtëse prej dy (2) pikë negative[3]. Automjeti me pajisje inteligjente i NJRTRR-Prizren nuk ka pasur matje të mjaftueshme për tejkalim të shpejtësisë dhe duket se nuk shfrytëzohet sa duhet. Në mungesë mostrash, IPK ka inspektuar mostrat e dhjetë (10) regjistrimeve që ka kapur mjeti me pajisje inteligjente, për mjetet e pa regjistruara, që janë hasur duke lëvizur në trafik[4]. Nga verifikimi i këtyre mostrave në SIPK, vetëm për njërën prej tyre janë hasur të dhëna se është shqiptuar gjobë. Edhe automjeti me pajisje inteligjente i NJRTRR - Gjakovë nuk ka pasur matje të mjaftueshme për tejkalim të shpejtësisë dhe duket se edhe ky nuk shfrytëzohet sa duhet. IPK ka siguruar vetëm katër (4) mostra të matjeve për tejkalim të shpejtësisë me +20 km/h më shumë se shpejtësia e lejuar. Për asnjërën prej këtyre matjeve nuk është dokumentuar të jenë shqiptuar gjoba[5]. Edhe këtu, IPK-ja ka inspektuar mostrat e dhjetë (10) regjistrimeve të kapur automjeti me pajisje inteligjente, për mjetet e pa regjistruara që janë hasur duke lëvizur[6]. Nga verifikimi i mostrave në SIPK ka rezultuar se për asnjërën prej tyre nuk janë hasur të dhëna se janë shqiptuar gjoba.
Përfundim	Bazuar në gjetjet e inspektimit, IPK-ja vlerëson se: 1. Përdorimi i pajisjeve për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve në trafik është i lejueshëm me normativën ligjore në fuqi dhe duket të jetë mjet i vlefshëm për parandalimin e aksidenteve në rrugë dhe përgjithësisht ngritjen e sigurisë rrugore. 2. Policia e Kosovës, me theks të veçantë njësitë e trafikut rrugor kanë në dispozicion pajisje të avancuara për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve në rrugë, si dhe identifikimin e shkeljeve tjera në trafik. 3. Edhe pse para fillimit të përdorimit të pajisjeve ka pasur sesione trajnuese në njësi, duket sikur këto nuk janë të mjaftueshme, meqë inspektimi po pasqyron dobësi në përdorimin e duhur të radarëve dhe automjeteve me pajisje inteligjente. 4. Njësive të trafikut rrugor u është shpërndarë manuali i përdorimit të pajisjeve, por se ruajtjes së regjistrimeve nuk i është kushtuar kujdes i duhur, andaj nxjerrja e një procedurë të shkruar do të ishte udhërrëfyes për mënyrën dhe rregullat e përdorimit të pajisjeve, përfshirë dhe ruajtjen e regjistrimeve.

[3] Fletë kundërvajtja nr. 0004259438A (datë 13.05.2025).
[4] Targat e automjeteve të pa regjistruara: 04-281-JR, 04-677-IF, 01-243-MN, 04-656-JK, 04-303-JK, 04-771-KJ, 04-260-KL, 04-920-KI, 04-426-JR dhe 04-789-IL.
[5] Targat e automjeteve me tejkalim të shpejtësisë së lëvizjes: 03-537-GB (50/80 km/h), 07-384-FJ (50/90 km/h), 01-673-SQ (60/103 km/h) dhe 04-478-IO (60/88 km/h).
[6] Targat e automjeteve të pa regjistruara: 07-703-EQ, 05-955-ES, 07-748-DT, 07-421-AN, 07-971-FA, 07-116-EK, 07-343-FD, 07-332-FE, 03-991-EI dhe 03-213-HL.

	5. Para kryerjes së matjeve me radar të dorës, nga ana e disa njësive nuk i kushtohet rëndësi sa duhet vendosjes së të dhënave të nevojshme në pajisje, si: kufizimit të shpejtësisë se lëvizjes, lokacionit te matjes dhe atyre mbi operatorët. 6. Rezultatet e matjeve me radar të dorës shpesh nuk korrespondojnë me të dhënat në gjoba dhe këto dobësi shfaqin dyshime për abuzime dhe punë jo profesionale. Disa prej këtyre dobësive janë hasur edhe tek radari mobil i njërës prej njësive. 7. Derisa gjobat e shqiptuara me pajisje inteligjente në automjete dëshmohen me foto, të cilat printohen nga printer mobil, kjo nuk ndodhë edhe me gjobat që shqiptohen pas matjeve me radar të dorës (Trucam). 8. Zbutja e gjobave në raport me shkeljet, ndryshimi i llojit të shkeljeve, aplikimi jo i plotë i gjobave ndaj kundërvajtësve, mospërputhje e të dhënave mbi shpejtësinë e matur dhe atë të lejuar, janë disa nga dobësitë që janë hasur gjatë inspektimit. 9. Njësitë e trafikut rrugor nuk janë duke shfrytëzuar sa duhet mundësitë që ofrojnë automjetet me pajisje inteligjente dhe duket sikur ka një hezitim, apo një mungesë gatishmërie për t'iu përshtatur punës me këto pajisje të avancuara. 10. Pa dashur të ndikojë në ngritjen e numrit të gjobave, IPK vetëm iu rikujton njësive të trafikut se numri i matjeve me shkelje të dokumentuara dhe të ndodhura është në disproporcion me numrin e gjobave, andaj synim duhet të jetë ngritja e sigurisë rrugore dhe disiplinimi i ngasësve që rrezikojnë trafikun.

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	**Rekomandimi**	**Niveli i prioritetit**	**Komentet e strukturës policore (në origjinal)**	**Plani i veprimit**
1.	*IPK i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Trafikut Rrugor, që të ndërmarrë veprime në drejtim të nxjerrjes së një udhëzuesi lidhur me përdorimin e pajisjeve për matjen e shpejtësisë së lëvizjes, përfshirë dhe ruajtjen e regjistrimeve, në të kundërtën, mbajtja e një trajnimi shtesë do të ishte i duhur për të pajisur personelin me njohuri të mjaftueshme.*	*-I-*	*Drejtori i Divizionit të Trafikut Rrugor cakton zyrtarin përkatës i cili do të analizoj raportin dhe rekomandimet në detaje dhe do të del me një Draft PSO lidhur me çështjet e paraqitura në këtë rekomandim. Të gjitha pajisjet të cilat janë cekur në rekomandimin 4 dhe 5 do të trajtohen në draft PSO-në që do të hartohet.*	*TM-4 2025*
2	*IPK iu rekomandon shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve në kuadër të njësive rajonale të trafikut rrugor, që të ushtrojnë kontrolle mbi ekipet patrulluese, në drejtim të eliminimit të dobësive sa i përket vendosjes së të dhënave në pajisjet e matjes së shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve (kufizimi i shpejtësisë, lokacioni, operatorët).*	*-I-*	*Drejtorët Rajonal të DRP-ve caktojnë Shefat e Operativës Rajonale, të cilët do të mbikëqyrin angazhimin e Komandantëve të Njësive Rajonale të Trafikut Rrugor në lidhje me menaxhimin dhe kontrollin e duhur, duke pasur parasysh implementimin në tërësi të rekomandimit të dhënë nga IPK. Duke mbikëqyrur dhe realizuar kontrolle të rregullta gjatë çdo ndërrimi, për të siguruar që të gjitha parametrat e domosdoshëm në pajisje të jenë të saktë dhe të dokumentuar. Ekipet patrulluese para fillimit të ndërrimit duhet të vendosin të dhënat, si: kufizimi i shpejtësisë në zonë, lokacioni i saktë i vendosjes së pajisjes dhe emrat e operatorëve. Këto të dhëna duhet të dokumentohen edhe në raportet ditore të patrullimit.*	*Në vazhdimësi*
3.	*IPK iu rekomandon shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve në kuadër të njësive rajonale të trafikut rrugor, që të ushtrojnë kontrolle mbi ekipet patrulluese, në drejtim të eliminimit të praktikave të dëmshme (ndryshimi i llojit të shkeljes, mos aplikimi i plotë gjobës, të dhëna kontradiktore ndërmjet shpejtësisë së matur me atë të përshkruar në gjobë, etj.), duke konsideruar se ulin seriozitetin dhe profesionalizimin.*	*-I-*	*Drejtorët Rajonal të DRP-ëve caktojnë Shefat e Operativës Rajonale të cilët do të mbikëqyrin angazhimin e Komandantëve të Njësive Rajonale të Trafikut Rrugor lidhur me menaxhimin dhe kontrollin e duhur si dhe të bëjnë një analizë lidhur me ndryshimin e llojit të shkeljes, mos aplikimin e plotë të gjobave, të dhëna kontradiktore ndërmjet shpejtësisë së matur me atë të përshkruar në gjobë, etj.), duke dal me një raport përmbajtësor nga i cili do të dalin edhe rekomandimet lidhur me përmirësimin e gjendjes dhe zbatimin e plotë të rekomandimit të dhënë nga IPK.*	*Në vazhdimësi*
4.	*IPK iu rekomandon shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve në kuadër të njësive*	*-I-*	*Drejtorët Rajonal të DRP-ve caktojnë Shefat e Operativës Rajonale, të cilët do të mbikëqyrin*	*Në vazhdimësi*

	rajonale të trafikut rrugor, që sigurohen se ekipet patrulluese janë duke shfrytëzuar mjaftueshëm automjetet me pajisje inteligjente, në identifikimin e kundërvajtësve që rrezikojnë komunikacionin duke lëvizur me shpejtësi mbi atë të lejuar, por edhe identifikimin edhe të atyre që qarkullojnë me automjete të pa regjistruara.		*angazhimin e Komandantëve të Njësive Rajonale të Trafikut Rrugor lidhje me menaxhimin dhe kontrollin e duhur duke pasur parasysh implementimin në tërësi të rekomandimit të dhënë nga IPK.*	
5.	*IPK iu rekomandon shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve në kuadër të njësive rajonale të trafikut rrugor, që të monitorojnë procesin e shkarkimit të materialeve të regjistruara nga pajisjet e matjes së shpejtësisë, duke siguruar se ato edhe ruhen në mënyrën e duhur.*	*-I-*	*Drejtorët Rajonal të DRP-ve caktojnë Shefat e Operativës Rajonale të cilët do të mbikëqyrin angazhimin e Komandantëve të Njësive Rajonale të Trafikut Rrugor lidhur me menaxhimin dhe kontrollin e duhur duke pasur parasysh implementimin në tërësi të rekomandimit të dhënë nga IPK.*	*Në vazhdimësi*
6.	*IPK i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Trafikut Rrugor dhe shefave të njësive rajonale të trafikut rrugor, që të ndërmarrë veprime në drejtim të aplikimit të praktikës së printimit të kundërvajtjeve, në rastet e matjeve me radar të dorës Trucam nga njësitë patrulluese.*	*-I-*	*Drejtori i Divizionit të Trafikut Rrugor do të kërkoj nga Komandantët e Njësive të Trafikut dhe njësive tjera që posedojnë radar të dorës, apo pajisje tjera që kanë printer, që të sigurojnë letër printimi dhe pajisjen ta mbajnë në gjendje të rregullt, me qëllim që çdo kundërvajtje nga këto pajisje të printohet dhe të dëshmohet.*	*TM-4 2025*
7.	*IPK i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Trafikut Rrugor, që në bashkëpunim edhe me Ministrinë e linjës, të shqyrtojë mundësitë e pajisjes edhe me radar statik, për të ushtruar kontroll efektiv mbi kundërvajtësit në zona me rrezik të lartë, të njohura si pika të nxehta të ndodhjes së aksidenteve rrugore.*	*-I-*	*Drejtori i Divizionit të Trafikut Rrugor së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm kanë adresuar kërkesën në MMPHI për vendosjen e pajisjeve statike për mbikëqyrje dhe kontroll të trafikut në autostrada dhe rrugë tjera nacionale, që vlerësohen me prioritet (jemi në pritje të përgjigjes nga MMPHI).*	*Në vazhdimësi*